

BULETIN INFORMATIV

Janar - Dhjetor 2008

**KOMISIONI PËR SHËRBIME PUBLIKE, ADMINISTRATË
LOKALE DHE MEDIA**



Kuvendi i Republikës
së Kosovës



Janar - Dhjetor 2008



Fjala hyrëse e Kryetarit të Komisionit



Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media është njëri nga 11 komisionet funksionale të Kuvendit të Kosovës, i cili brenda fushëveprimtarisë së tij ka tri fusha të rëndësishme dhe mjaft të gjera: shërbimet publike, administratën lokale dhe mediat.

Përbërja e komisionit reflekton grupet politike të përfaqësuara në Kuvend ndërkaq, udhëhiqet nga partia opozitare Aleanca Kosova e Re.

Për të përmbushur misionin e tij, aktivitetet e komisionit gjatë vitit 2008 janë përqendruar në tri drejtime kryesore: shqyrtimin e projektligjeve për te cilat Komisioni ka qenë funksional, në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në teren dhe në sigurimin e një baze të qëndrueshme ligjore që do të siguronte zhvillimin e mediave të lira.

Fryma kolegjiale dhe përkushtimi i anëtarëve si dhe mbështetja nga stafi, ka kontribuar që gjatë vitit 2008 të realizohen me përpikëri aktivitetet e parapara me plan të punës.

Meqë, Komisioni ynë do të ketë rol të rëndësishëm në vijim, sidomos në mbikëqyrjen e ecurisë së reformave në administratën publike, mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve si dhe në sigurimin e një baze të qëndrueshme për zhvillim të mediave të lira, ndihet nevoja që Kuvendi i Kosovës të rris mbështetjen e tij me staf profesional dhe mjete buxhetore. Gjithashtu, Komisioni e vlerëson mbështetjen e deritanishme të partnerëve të jashtëm (si USAID, NDI, OSBE) dhe pret që kjo mbështetje të vazhdoj edhe më tutje.

Esat Brajshori

Kryetar i Komisionit



Fushëveprimtaria e Komisionit

Komisioni Parlamentar për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media është njëri nga 11 komisionet funksionale të Kuvendit të Kosovës. Përbëhet nga 11 anëtarë që përfaqësojnë partitë politike të përfaqësuara në Kuvend. Fushëveprimtaria e tij shtrihet në tri fusha mjaft të gjëra si: shërbime publike, administratë lokale dhe media. Në bazë të përshkrimit të detyrave, puna e këtij Komisioni konsiston në: shqyrtimin e përcaktimit dhe koordinimit të politikës



së punës për një shërbim objektiv civil për të gjithë qytetarët pa dallime etnike, mbi bazën e objektivitetit, të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë; projekteve të aftësimit kadrovik dhe profesional të kuadrove për shërbimin civil; propozimin e masave për ofrimin e shërbimeve të inxhinierisë

dhe të menaxhimit të ndërtesave për Institucionet e Kosovës; propozimin e masave për administrimin e sistemit të pagesave dhe listën e pagave të Shërbimit civil; shqyrtimin e standardeve dhe shërbimeve të teknologjisë informative që duhet përdorur në Institucionet e Kosovës, etj. Gjithashtu, Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, është përgjegjës për shqyrtimin dhe amendamentimin e ligjeve si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve nga organet ekzekutive.

Kompetencat ekzekutive nga këto fusha i mbulojnë: Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal, të cilat janë edhe sponsorizueset kryesore të projektligjeve për të cilat ky komision është funksional.



Plani i Punës 2008

Më 14 Mars, Komisioni ka miratuar Planin vjetor të punës, me të cilën ka paraparë dinamikën e punëve për vitin 2008. Hartimi i Planit të punës në masë të madhe është bazuar në Strategjinë Legjislative të Qeverisë dhe ka paraparë: shqyrtimin e Projektligjeve nga fushat që i mbulon, organizimin e dëgjimeve publike, vizita në teren, monitorimin e zbatimit të ligjeve etj.

Gjithashtu, me këtë plan, Komisioni, ka parë parasysh nevojën e thellimit të komunikimit ndërmjet stafit mbështes të Komisionit me Zyrës ligjore të Qeverisë, Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.



Takimet e Komisionit

Në bazë të Rregullores së punës Komisioni, mban së paku 2 takime gjatë muajit. Gjatë vitit 2008, ky Komision ka përmbushur obligimet e parapara dhe gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2008 ka mbajtur 20 takime, 2 vizita ne teren dhe ka realizuar një vizitë në Kroaci.

Shqyrtimi dhe Amendamenti i Projektligjeve

Gjatë vitit 2007, Komisioni ka shqyrtuar tri projektligje, dy prej të cilave ishin ligje të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, por të cilat nuk janë nënshkruar nga PSSP, si dhe ka filluar procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të dy ligjeve. Projektligjet, përkatësisht ligjet pa nënshkruara nga PSSP, që ka shqyrtuar ky Komisioni ishin: Projektligji për Vulat në Institucioneve të Republikës së Kosovës, Ligjin për Gjendjen Civile dhe Ligjin për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo qeveritare. Ndërkaq, ka filluar procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës dhe Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.



Dëgjimet Publike

Gjatë punës së tij në shqyrtimin e Projektligjeve, Komisioni, mund të organizojë dëgjime publike për të marrë opinionin e organizatave, ekspertëve apo grupeve që ndikohen nga projektligji. Mirëpo, Komisioni mund të organizojë dëgjime edhe në rastet kur ka vërejtje në zbatimin e Ligjeve apo kërkesave për ndryshime eventuale në ligjet në fuqi. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2008, Komisioni ka organizuar dy dëgjime publike. Të dyja këto dëgjime janë organizuar lidhur me Ligjin për lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. Në këto dëgjime janë ftuar përfaqësuese të organizatave dhe ekspertë të cilët janë ndikuar drejtpërdrejt nga Ligjet si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre Ligjeve.

Dëgjimet publike, e ndihmojnë Komisionin që të marrë vendime më të drejta dhe në përputhje me interesin e grupeve dhe qytetarëve që preken më së shumti nga zbatimi i atyre Ligjeve.

Vizitat në teren

Për zbatimin e Ligjeve nga fusha që mbulon Komisioni kryesisht, janë përgjegjëse institucionet e nivelit komunal. Andaj për të parë nivelin e zbatimit të Ligjeve, më për së afërmi, Komisioni



organizon vizita ne teren. Gjatë vitit 2008, Komisioni ka vizituar komunën e Prizrenit dhe komunën e Podujevës. Vizitat ishin organizuar me qëllim të monitorimit të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare dhe të Ligjit për përdorim të gjuhëve si dhe për të dëgjuar shqetësimet dhe nevojat e institucioneve lokale në zbatimin e ligjeve dhe ofrimin e shërbimeve. Shqetësimet dhe nevojat e tyre, Komisioni i adreson në institucionet Qendrore relevante.



Monitorimi i Implementimit të Ligjeve

Përveç që është Komision funksional në këto fusha dhe kontribuon në përmirësimin e kualitetit të projektligjeve që vijnë në Kuvend, Komisioni ushtron edhe funksionin e mbikëqyrjes së punëve të institucioneve ekzekutive. Gjatë këtij viti (2008), Komisioni ka qenë mjaft aktiv në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Në këtë kuadër janë shqyrtuar dhe në vazhdimësi përcillet implementimi i Ligjeve për të cilat gjatë miratimit ka qenë Komision funksional



Gjatë këtij viti kujdes të veçantë i ka kushtuar zbatimit të katër ligjeve në fushat që i mbulon ky Komision: Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, Ligjit për përdorimin e Gjuhëve si dhe përmes kërkesave për raportim nga Radio Televizioni i Kosovës dhe Komisioni i Pavarur i Mediave ka mbikëqyrrur zbatimin e Ligjit për RTK-në, përkatësisht Ligjin për KPM-në.

KOMISIONI PËR SHËRBIME PUBLIKE, ADMINISTRATË LOKALE DHE MEDIA



Esat Brajshori (AKR)
Kryetar i Kmisionit



Hajredin Hyseni (PDK)
Zëvendëskryetar i Parë



Spresa Murati (7+)
Zëvendëskryetare e Dytë



Melihate Tërmkolli (LDK)
Anëtare



Anita Morina-Saraçi (LDK)
Anëtare



Rasim Selmanaj (AAK)
Anëtar



Synavere Rysha (LDD)
Anëtare



Ali Lajçi (LDK)
Anëtar



Radmila Vujović (SLS)
Anëtare



Hajdin Abazi (PDK)
Anëtar



Emrush Xhemajli (PDK)
Anëtar



Kontaktet

Marrëdhëniet me Publikun

Sherif Konjufca Shef i Seksionit

Zyra N - 08, Kati përdhes

038 211 186
sherif.konjufca@assembly-kosova.org

Stafi mbështetës i Komisionit

Shpresa Ramosaj Administratore e Zyrës
Drita Morina Zyrtare e Lartë Ligjore
Mirjeta Heta Nëpunëse Administrative

Zyra E - 211, Kati II

038 211 294
shpresa.amosaj@assembly-kosova.org
038 211 293
drita.morina@assembly-kosova.org
038 211 302
mirjeta.heta@assembly-kosova.org

Zyrtari nga NDI që mbështet Komisionin

Avni Zuka Zyrtar Legjislativ

Zyra N - 320, Kati III

038 212 532 azuka3@gmail.com
044 513 608

Webfaqja e Kuvendit

www.kuvendikosoves.org

Përkrahur nga:

